

TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 3 2008



**TLAS, GJITHNJË E MË SHUMË I
ANGAZHUAR NË MBROJTJET
E TË DREJTAVE TË SHITESAVE
VULNERABËL DHE RITJEN E
AKSESIT NË DREJTËSI TË KË-
TYRE SHITESAVE.
ZBATIMI I PROJEKTIT TË
FINANCUAR NGA UNICEF
2008 - 2009**

Tashmë, prej 10 vjetësh, Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) është angazhuar në mbrojtjen e të drejtave ligjore dhe sociale të shtetasve në nevojë dhe ritjen e aksesit të individëve apo grupeve vulnerabël në shërbimet ligjore dhe sociale që ofrohen nga organet shtetërore apo ato gjyqësore.

Gjatë kësaj periudhe, TLAS është përballur me sfida, vështirësi, por edhe me suksese të cilat e kanë bërë TLAS të njohur ndërmjet shtetasve në nevojë dhe grupeve të synuara, por edhe ndërmjet donatorëve dhe organeve shtetërore.



Vetë miratimi i Projekt-Ligjit “Për Ndihmën Ligjore” në Këshillin e Ministrave, projekt-ligj i iniciuar nga TLAS dhe kalimi i tij për shqyrtim e më pas për në Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë është një sukses mjaft i madh në ritjen e aksesit në drejtësi të të gjithë qytetarëve, barazinë e shtetasve në proceset ligjore, por edhe në arritjen e standardeve ndërkombëtare të kërkuara nga Shqipëria.



Krahas kësaj nisme ligjore, TLAS ka iniciuar dhe ndryshime dhe përmirësime të tjera ligjore siç ishte ai i ndryshimit të Ligjit “Për Gjendjen Civile”, financuar nga UNICEF, ndryshim i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në Qershor 2008.

Në kuadër të zbatimit të ndryshimeve të reja të ligjit të sipërpërmendur, TLAS do të ndërmarrë disa aktivitete, të financuara përsëri nga UNICEF për trajnimin e punonjësve të zyrave

të gjendjes civile, në mënyrë që shërbimet që do t’i ofrohen publikut të jenë sa më cilësore dhe sa më të shpejta.

Nevoja e një komunikimi sa më etik dhe dhënia e informacionit të duhur ligjor për individët në nevojë është çështja më universale, themelore dhe më e vështirë me të cilën përballen sot punonjësit e zyrave të gjendjes civile.

Çdo ditë ata përballen me një sërë pyetjesh për dokumentet e nevojshme që duhet të japë gjendja civile dhe që do të përdoren për qëllime të ndryshme, si për shembull për sistemin e përfitimeve sociale, regjistrimin e lindjeve, vdekjeve, divorceve, residencave, punësimit, etj., si dhe procedura të tjera të shumta, për të cilat punonjësit e zyrave të gjendjes civile duhet të vendosin se çfarë informacioni duhet dhënë.

Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti do të synohet:

Së pari, cili është informacioni që do të konsiderohet i nevojshëm, brenda etikës profesionale të këshillimit, dhe cilat janë udhëzimet që këta punonjës duhet të japin në mënyrë që të shmangët mosdhënia e informacionit të nevojshëm për publikun e gjerë në përgjithësi dhe për njerëzit në nevojë, në veçanti.

Së dyti, nevoja për unifikimin e standarteve në të gjithë vendin për shërbimet e ofruara. Unifikimi i standarteve është i nevojshëm për shkak të përkufizimeve dhe përcaktimeve që ndryshojnë nga një zyrë e gjendjes civile në tjetrën. Zyra të ndryshme kanë praktika të ndryshme për informacionin që mund të ofrojë ose jo punonjësi i zyrës së gjendjes civile. Ajo që duhet kuptuar pas kësaj, është që individët në zyra të ndryshme të vendit mund të mos marrin të njëjtin shërbim dhe informacion për çështjet e tyre, e si pasojë mund të mos kenë të njëjta mundësi dhe aftësi për të patur akses në shërbimet e tjera të ofruara, qoftë ato ligjore apo sociale.



Së treti, informacioni që mund të jetë i disponueshëm është në një format jo shumë të përdorshëm. Këta punonjës kanë nevojë për mjete që t'u japin atyre mundësinë të komunikojnë me publikun shpejt, në mënyrë etike dhe efikase.

Së fundi, duke qenë se sistemet e informacionit të Gjendjes Civile po sofistikohen gjithnjë e më tepër, punonjësit e zyrave të gjendjes civile kanë nevojë

edhe për trainime të këtij lloji, duke qenë se deri tani ato kanë punuar me sisteme të bazuara me shkrimin në letër.

Trainimi i punonjësve të Zyrave të Gjendjes Civile, nga TLAS me financimin e UNICEF, jo vetëm që do të përgatisë këta punonjës për të ofruar një shërbim sa më cilësor, por nga ana tjetër do të lehtësojë dhe mënyrën e përfitimit të këtyre shërbimeve nga ana e qytetarëve.

Kjo do të ndihmojë TLAS në ndjekjen dhe përfaqësimin e njerëzve në nevojë për regjistrimet në zyrat e gjendjes civile të individëve dhe grupeve vulnerabël dhe për të patur një akses sa më të mirë në shërbimet ligjore, sociale, të shëndetit, etj.

Të gjitha aktivitetet e TLAS nën këtë projekt do të jenë në funksion të zbatimit të Strategjive të miratuara nga Qeveria Shqiptare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve vulnerabël, veçanërisht atij Rom.

I gjithë zbatimi i projektit dhe i aktiviteteve do të bazohet në përvojën e deritanishme të TLAS, në arritjet e tij, në cilësitë e stafit dhe do të kryhet nëpërmjet strategjive të tilla si shërbimet e drejtpërdrejta ligjore dhe paraligjore me anë të përfaqësimeve në gjykatë dhe organe administrative, publikimeve, të cilat do të shërbejnë në fushatat e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit, kontakteve të drejtpërdrejta në ko-



munitet, nëpërmjet aktiviteteve të street law, etj.

Kemi bindjen e plotë se ky projekt do të zbatohet dhe do të realizohet me sukses dhe të gjitha objektivat e parashikuara në të do të arrihen.

Individët në nevojë do të përfitojnë shërbime cilësore dhe të shpejta nga TLAS.

Elton Lula
Manaxher Programi
TLAS



KONVENTA KUADËR PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE KOMBËTARE NË 10 VJETORIN E SAJ

Në datat 9-10 tetor 2008, nën kujdesin e Këshillit të Evropës, u mbajt në Strasburg Konferenca për vlerësimin e arritjeve me rastin e 10 vjetorit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Në konferencë merrnin pjesë

personalitete të Këshillit të Evropës, kryesues dhe anëtarë të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër, anëtarë të komisionit të të Drejtave të Njeriut pranë Këshillit të Evropës dhe përfaqësues të një numri të madh Organizatash jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe të të drejtave të Romëve.

Këshilli i Evropës është një organizatë shtetesh. Ajo përbëhet nga 46 shtete anëtare. Ai përdor mekanizma politike dhe juridike apo quasi-juridike për kryerjen e veprimtarisë së tij. Trupi ekzekutiv i saj është Komiteti i Ministrave, që përbëhet nga ministrat e punëve të jashtme të çdo shteti anëtar. Forumi vendimmarrës i saj është Asambleja Parlamentare, që përbëhet nga parlamentarë të grupeve të ndryshme politike. Këshilli i Evropës ka mekanizma ligjore për të monitoruar detyrimet e shteteve për angazhimet që kanë marrë ndaj konventave të Këshillit të Evropës.



Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (KKMMK) u hartua nga Komiteti Ad Hoc për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të Këshillit të Evropës, nën autoritetin e Komitetit të Ministrave dhe u miratua nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në 10 nëntor 1994 dhe filloi të nënshkruhej nga shtete anëtare të Këshillit të Evropës në 1 shkurt 1995. Konventa hyri në fuqi në 1 shkurt 1998.

KKMMK është instrumenti kryesor i Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të personave që i përkasin minoriteteve kombëtare. Ajo është detyruese për shtetet që e kanë ratifikuar atë. Pra shtetet duhet ta pasqyrojnë këtë Konventë në ligjet, në politikat dhe në praktikën e të gjitha institucioneve. Termi “Kuadër” tregon që Konventa përmban kryesisht dispozita të tipit programor dhe jo thjesht përkufizime të të drejtave individuale, megjithëse ajo i referohet këtyre të drejtave. Kjo do të thotë që fokusi i saj është përqëndruar

në atë që çfarë duhet të bëjnë shtetet që të garantojnë një të drejtë dhe jo në vetë të drejtën. Komiteti Këshillues që u ngrit në vitin 1998, përbëhet nga 18 ekspertë të pavarur dhe ka një rol kyç në monitorimin e zbatimit të konventës nga shtetet. Detyra e tij është të sigurojë zbatimin e standarteve të Konventës nga çdo shtet, në fushat e ndryshme të interesit të personave që ju përkasin minoriteteve kombëtare. 39 shtete të Evropës kanë ratifikuar KKMMK, 4 shtete të tjerë e kanë firmosur, duke





bërë të njohur mbështetjen e tyre në parim, ndërsa 4 shtete të tjera nuk e kanë ratifikuar. Shqipëria e ka ratifikuar KKMMK në qershor 1999.

KKMMK është shprehje e qëllimit të Këshillit të Evropës për të arritur një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim mbrojtjen dhe realizimin e parimeve të përbashkëta të të drejtave të njeriut dhe lirive bazë. Historia e Evropës ka treguar që mbrojtja e minoriteteve kom-

bëtare është thelbësore për stabilitetin, sigurinë dhe paqen në kontinent. Një shoqëri pluraliste dhe demokratike duhet që jo vetëm të respektojë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo personi që i takon një minoriteti kombëtar, por gjithashtu duhet edhe të krijojë kushtet për aftësimin e tyre për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar këtë identitet. Krijimi i një klime tolerance dhe dialogu është i nevojshëm për të mundësuar diversitetin kulturor, si një burim pasurimi dhe jo faktor ndarjeje për shoqërinë.

Krijimi i një Evrope tolerante dhe të begatë nuk varet vetëm nga bashkëpunimi ndërmjet shteteve, por ajo kërkon edhe bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet autoriteteve vendore dhe rajonale pa paragjykim për krijimin dhe integritetin tokësor të çdo shteti. Neni 1 i KKMMK thotë që mbrojtja e minoriteteve kombëtare dhe e të drejtave dhe lirive të personave që iu përka-sin këtyre minoriteteve përben një pjesë integrale të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave

të njeriut dhe si e tillë qëndron në bazë të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në KKMMK theksohet parimi i rëndësishëm që çdo person që i përket një minoriteti duhet të ketë të drejtën të zgjedhë lirisht nëse ai dëshëron të trajtohet apo jo si pjesë e minoritetit dhe nga kjo zgjedhje nuk duhet të ketë asnjë lloj disavantazhi. Personat që ju përkasin minoriteteve mund të ushtrojnë të drejtat dhe të gëzojnë liritë që rrjedhin nga parimet e KKMMK si në mënyrë individuale, ashtu edhe në grup, së bashku me të tjerët.

Neni 4 i KKMMK ka një rëndësi shumë të madhe, sepse përcakton detyrimin e shtetit që t'iu garantojë personave që ju përkasin minoriteteve të drejtën e barazisë përpara ligjit dhe të një mbrojtje të njëjtë nga ligji. Çdo diskriminim që bazohet në përkatësinë në një minoritet duhet të ndalohet. Por jo vetëm kaq. Shtetet duhet të ndërmarrin masa të përshtatëshme për të promovuar, në të gjitha fushat

e jetës, ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave që ju përkasin minoriteteve kombëtare dhe atyre që ju përkasin shumicave. Dhe është shumë i rëndësishëm fakti që në KKMMK theksohet që marrja e masave të përshkruara më sipër, nuk duhet të konsiderohet si një veprim diskriminues.

Sipas KKMMK, shtetet duhet të krijojnë kushtet e nevojshme që personat që i përkasin minoriteteve, të ruajnë dhe të





zhvillojnë kulturën e tyre, të ruajnë elementët kryesorë të identitetit të tyre, si fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore. Shtetet nuk duhet të zbatojnë politika dhe praktika të asimilimit të minoriteteve.

KKMMK ka qënë një mjet i fuqishëm për mbrojtjen e minoriteteve që me hyrjen e tij në fuqi. Përdorimi i Konventës ka rritur ndërgjegjësimin e të gjithë shoqërive ku jetojnë mi-

noritete, ka shërbyer për trajnimin e shoqërisë civile, duke rritur mundësitë e saj për ndërgjegjësim, për monitorim dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së OJF-ve që punojnë në këto fusha.

Elvira Dervishi
Keshilltare Programi
TLAS

Histori e vërtetë

R.S. jeton në një çadër të ngritur pranë liqenit artificial të Tiranës, sëbashku me tre fëmijët e saj dhe me personin me të cilin ajo bashkëjeton. Ata e nxjerrin bukën e gojës nga shitja e sendeve të ndryshme, që grumbullojnë nga kazanët e hedhjes së mbeturinave. Ajo ka një fëmijë 3 muajsh të paregjistruar ende në gjendjen civile, të lindur nga bashkëjetesa me

Z.I. Ndërkohë R.S. ligjërisht figuron e martuar me një tjetër person, me të cilin ka dy fëmijë. Këta fëmijë janë të regjistruar në gjendjen civile.

R.S. u drejtua në TLAS për të pyetur se si duhet të vepronte për të regjistruar fëmijën e saj. Nga ana jonë ajo u sqarua se në bazë të legjislacionit në fuqi, kur të regjistrohej fëmija, do të mernte automatikisht mbiemrin e bashkëshortit legal të nënës



së tij dhe më vonë, nëpërmjet gjykatës do bëhej kundërshtimi i atësisë së fëmijës dhe njohja e atësisë së vërtetë të tij. Për ndjekjen e të gjithë këtyre procedurave, ajo do mbështetej nga avokatët e TLAS.

R.S. kërkon të bëjë zgjidhjen e martesës nga bashkëshorti i saj, meqë ai e keqtrajton dhe nuk kujdeset për mbarëvajtjen e familjes dhe të fëmijëve. Ajo dëshiron që më vonë të lidhë martesë me Z.I. që është edhe babai i fëmijës së saj të tretë dhe me të cilin ka krijuar një jetë më të mirë.



Për të normalizuar gjëndjen e familjes së R.S. duheshin bërë disa ndërhyrje urgjente. TLAS ka filluar nga puna për realizimin e të gjithë hapave të nevojshëm:

1. Regjistrimi i fëmijës së tretë në regjistrin e gjëndjes civile. Duke qënë fëmija i regjistruar dhe me identitet të përcaktuar do fillohet më vonë gjyqi për kundërshtimin e atësisë.
2. TLAS ndihmoi R.S. që të grumbullojë të gjitha certifikatat e nevojshme të gjëndjes civile (7 copë) dhe të fillojë procedurat gjyqësore për zgjidhjen e martesës nga bashkëshorti dhe marrjen e kujdestarisë së dy fëmijëve nga nëna.
3. Mbas realizimit të zgjidhjes së martesës, kur R. S. të figurojë si kryefamiljare me tre fëmijë, TLAS do ta ndihmojë të përgatisë dokumentacionin për përfshirjen në skemën e përfitimit të përkrahjes sociale në njësinë bashkiake ku ajo është e regjistruar. Për këtë duhet të merret një certifikatë e gjëndjes civile, për përkrahjen sociale.

4. Njëkohësisht do përgatishim dokumentacionin që familja e saj të regjistrohet në njësinë bashkiake si e pastrehë, për t'i krijuar mundësinë për të përfituar nga programet e strehimit që kanë filluar të zbatohen nga Bashkia e Tiranës. Për këtë TLAS do ta ndihmojë në plotësimin e formularit tip të kërkesës për t'u trajtuar me strehim, që më pas do të noterizohet dhe do të dorëzohet në njësinë bashkiake, kundrejt një pagese. Duke parë pamundësinë e saj ekonomike, TLAS do të bëjë edhe pagesën e të gjitha shpenzimeve të nevojshme.

Elvira Dervishi
Keshilltare Programi
TLAS



Histori e vërtetë

S.L.I. ka dy fëmijë dhe që të dy sishin të peregjistruar në gjendjen civile. Vajza e saj M. ishte madhore kur lindi dy fëmijë, por nuk mund t'i regjistronte as ata, meqë ajo vetë ishte e peregjistruar. Pra në familjen e S.L.I. kishte katër persona të peregjistruar në gjendjen civile. S.L.I. nuk kishte asnjë dokument nga materniteti për lindjen e dy fëmijëve të saj. Të gjithë këta persona kishin mbetur pa u regjistruar, për shkak se S.L.I. nuk kishte



shkuar të deklaronte lindjen e dy fëmijëve të saj brenda afateve ligjore të përcaktuara në bazë të ligjit të gjëndjes civile, që ishte në fuqi në atë kohë, dhe ajo duhet të bënte konfirmimin e lindjeve nëpërmjet gjykatës dhe të paguante gjobën përkatëse për secilin regjistrim të fëmijëve. S.Ll. nuk mund ta ndiqte këtë problem me gjykatë, për shkak të pamundësisë ekonomike për të paguar një avokat. Ajo nuk mund të paguante as gjobën e përcaktuar nga ligji. Dhe kështu fëmijët e saj kishin mbetur pa u regjistruar dhe për më tepër, vajza e saj e madhe lindi dy

fëmijë që mbetën edhe ata pa u regjistruar. Pra S.Ll. kishte edhe dy fëmijë edhe dy nipër të paregjistruar në gjëndjen civile.

Mbas ndryshimit të ligjit të gjëndjes civile në korrik 2008, u bë i mundur regjistrimi i çdo personi, në çdo kohë, pa patur afate ligjore të raportimit të lindjes. TLAS e kontaktoi S.Ll. në një ndër takimet e organizuara në komunitet dhe aty mësoi për problemet e saj. Duke u nisur nga datat e përafërta të lindjes së fëmijëve, të dhëna prej saj, morëm nga Materniteti Nr. 1 i Tiranës publikatat e lindjes së dy fëmijëve. Kështu u bë i mundur regjistrimi i fëmijëve në regjistrat e gjëndjes civile.

TLAS po vazhdon tashmë procedurat për regjistrimin e lindjes së dy nipërve të S.Ll., që janë fëmijët e M. Regjistrimi i këtyre fëmijëve në gjëndjen civile paraqet vështirësi, sepse M. në maternitet nuk ka dhënë mbiemrin e saj real, por atë të babait të saj biologjik B.Xh., që në fakt nuk e ka bërë njohjen e atësisë. Pra

në të dy çertifikatat e asistencës në lindje të lëshuara nga materniteti i Tiranës për të dy fëmijët, nuk figuron mbiemri real i M.

TLAS morri informacion që babai i M. punonte si emigrant jashtë shtetit dhe mundi të sigurojë numrin e tij të telefonit. Mbas një bisede telefonike me të, B.Xh. na siguroi që do të vinte brenda vitit 2008 në Shqipëri dhe do bënte njohjen e atësisë së vajzës së tij M. Mbas njohjes së atësisë dhe ndryshimit të mbiemrit të M. do të bëhet i mundur edhe regjistrimi i dy fëmijëve të saj.

Elvira Dervishi
Keshilltare Programi
TLAS



AKTI ADMINISTRATIV

Kuptimi i aktit administrativ.
Veçoritë e tij.

Akti administrativ duhet konceptuar si deklarim ose shfaqje e një vullneti pushteti nga organet që ushtrojnë veprimtari administrative, i kryer në përputhje të plote me kushtetuten dhe me ligjet në tërësi, me qëllim krijimin, ndryshimin ose shuarjen e pasojave të caktuara juridike që zbatohet nëpërmjet vullnetit të lirë të subjekteve të



cilëve iu drejtohet, ose me anë të fuqisë shtrënguese të shtetit. Në mënyrë më të thjesht “Akt administrativ” do të quhet çdo urdhër, vendim apo veprim që merret nga autoritetet administrative për rregullimin e një rasti të veçantë ose rasteve të përgjithshme në sferën e së drejtës publike.

K.Pr.A¹ për herë të parë në legjislacionin shqiptar ka dhënë kuptimin e aktit administrativ në nenin 105 “Për qëllimet e këtij

¹ K.Pr.A. - Kodi i Procedurave Administrative.



ligji, do të konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike në raste individuale”.

Forma e aktit administrativ

Shfaqja e vullnetit të pushtetit nga organi administrativ kërkon një formë të caktuar. Kryesisht aktet administrative kanë formë shkresore, me përjashtim të rasteve kur me ligj kërkohet një formë tjetër ose kur një gjë të tillë e imponojnë rrethanat. Aktet e organeve kolegjiale bëhen detyrimisht në formë shkresore vetëm në rastet kur një gjë të tillë e kërkon shprehimisht ligji. Në rastet e tjera këto akte regjistrohen në një procesverbal pa të cilin ato nuk shkaktjnë asnjë pasojë juridike.

Qëllimi i aktit administrativ

Aktet administrative, nxirren për një qëllim të caktuar për të krijuar ndryshuar ose shuar pasoja juridike konkrete për të gjithë subjektet që janë të detyruar

tu nënshtrohen urdhërimeve të bëra prej tij. Për këtë arsye akti duhet të tregoj në mënyrë të qartë qëllimin e tij. Pikërisht qëllimi për nxjerrjen e aktit administrativ përbën edhe vullnetin shtetëror të organit të administratës.

Akti administrativ duhet patjetër të përmbajë sa më poshtë:

- a) autoritetin që e nxjerr aktin, si dhe çdo delegim të pushteteve që lidhet me nxjerrjen e aktit;
- b) identifikimin e palëve, të cilave iu drejtohet akti;
- c) shpjegimin e fakteve, që janë bërë shkas për nxjerrjen e aktit, kur këto janë të rëndësishme;
- d) bazën ligjore të aktit kur kërkohet nga ligji;
- dh) shpjegimin e kuptimit të aktit;
- e) datën e hyrjes në fuqi të aktit;



- f) nënshkrimin e punonjësit të organit që nxjerr aktin ose të drejtuesit të organit kolegjal.

Arsyetimi i aktit administrativ

Çdo akt administrativ i shprehur ose i konfirmuar me shkrim duhet të përmbajë edhe arsyet e nxjerrjes se tij. Arsyetimi i aktit duhet të përfshijë faktet thelbësore, boshtin logjik dhe bazat ligjore që ka pasur parasysh autoriteti administrativ. Nëpërmjet arsyetimit të aktit qartësohet qëllimi që ka pasur organi. Arsyetimi përbën një element shumë të

rëndësishëm të formës që ndikon në vlefshmërinë e tij. Sipas nenit 116 të K.Pr.A mosrespektimi i formës dhe i procedurës së përcaktuar nga ligji përbën shkak për pavlefshmëri absolute të një akti. Për rrjedhojë rastet kur arsyetimi përbën domosdoshmëri për vlefshmërinë e një akti janë kur aktet:

a) mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa të ligjshëm ose vendosin apo rëndojnë detyrime apo ndëshkime;

b) përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për shqyrtim apo apelimet;

c) përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar;

d) përbëjnë devijim nga praktika e ndjekur për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme;

e) shkaktojnë revokimin, shfuqizimin, modifikimin ose pezullimin e një akti të mëparshëm.



Jo gjithmonë arsyetimi paraqitet i detyrueshëm, kemi dhe raste kur ky element nuk përbën çenim të vlefshmërisë së aktit si për aktet që ratifikojnë vendimet e marra nga bordet, juritë apo komisionet e ngritura nga administrata, si dhe urdhrat e eproreve, që kanë të bëjnë me çështje të brendshme, të cilat nuk kanë nevojë të arsyetohen. Arsyetimi duhet të jetë i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Kur arsyetimi është bërë me informacionet apo propozimet e mëparshme, mund të mjaftojë si arsyetim pranimi i tyre nga ana e organit përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar. Në këto raste informacionet dhe propozimet e mëparshme janë pjesë përbërëse e aktit.

Përdorimi për arsyetim i të dhënave të paqarta, kontradiktore ose të pasakta është i barazvlefshëm me mungesën e arsyetimit. Në rastet e çështjeve analoge mund të përdoren arsyetimet e bëra në çështjet e mëparshme, me kusht që të mos rëndohet pozita e palëve të interesuara.

Veçoritë e aktit administrativ

Katër janë veçoritë ose tiparet që e karakterizojnë aktin administrativ:

Së pari akti administrativ është një **akt juridik**, elementi juridik i një akti e përcakton fakti nëse ky akt krijon ose shuan një marrëdhënie juridike të caktuar.

Së dyti akti administrativ është **akt i njëanshëm**. Ai është shfaqje e nje vullneti juridik shtetëror të autoritetit kompetent. Aspekti i njëanshmërisë së aktit lidhet me kuptimin se detyrimisht dhe domosdoshmërisht në njërën anë të tij qëndron gjithmonë shteti përmes organit të administratës.

Së treti akti administrativ është specifike e organeve që kryejnë veprimtari administrative. Kjo veçori nënkupton që





nxjerrja e një akti administrativ është prerogative e organeve administrative që me ligj iu njihet kjo e drejtë. Organet administrative që kanë këtë tagër janë të gjithë ato që K.Pr.A i njeh si të tillë (neni 1).

Së katërti akti administrativ është akt nenligjor. Kjo veçori nënkupton që akti administrativ duhet të gjejë detyrimisht mbështetjen në ligj. Detyra e organit administrativ që nxjerr aktin është që të bazohet në ligj ose në aktin më të lartë dhe ta zbatojë atë.

- **Klasifikimi i akteve administrative**

Kriteret mbi të cilat bëhet klasifikimi i akteve administrative janë si më poshtë:

1 - Sipas nismës për nxjerrjen e aktit administrativ

- a. Aktet administrative të nxjerra me nismën e organit
- b. Aktet administrative të nxjerra me kërkesë të subjekteve të interesuar
- c. Aktet administrative që nxirren nga urdhërimet e ligjeve
- d. Aktet administrative që nxirren nga urdhërimet e vendimeve gjyqësore.

2 - Sipas formës së shprehjes së vullnetit

- a. Aktet administrative të nxjerra në formë shkre-sore
- b. Aktet administrative të nxjerra në formë verbale
- c. Aktet administrative që nxirren në formën e shen-jave

3 - Sipas efektit që sjell akti

- a. Aktet administrative de-tyruese
- b. Aktet administrative dobiprurëse

4 - Sipas karakterit të përmbajtjes së aktit

- a. Aktet administrative individuale
- b. Aktet administrative normative (i përgjithshëm)

5- Sipas emërimit të organit që e nxjerr

- a. Vendim
- b. Urdhëresë
- c. Rregullore
- d. Udhëzim
- e. Akt normativ me fuqinë e ligjit
- f. Urdhëri
- g. Dekreti

Naureda Llagami
Avokate
TLAS



Histori e vërtetë

Pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë është paraqitur klientia S. B. S.B është kryefamiljare e cila ka punuar për 28 vite dhe nuk ka mundur të përfitojë pension të pjesshëm pleqërie shtetëror. Klientja S.B kishte punuar 23 vite në Ndërmarrjen e Prodhimeve Artistike, Tiranë dhe 5 vite pune në Kooperativën Bujqësore Maminas. Nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Dega Tirane iu njoh e drejta për pension të pjesshëm pleqë-

rie kooperative. Klientia S.B nuk ishte dakord me vendimin e marrë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve, pasi ajo kishte punuar pjesën më të madhe në ndërmarrje shtetërore. Për këtë arsye ajo u paraqit pranë zyrës sonë, në mënyrë që të gjente një zgjidhje për problemin e saj. Avokati i TLAS-it pasi e shqyrtoi çështjen arriti në përfundimin se klientia kishte të drejtë në kërkimin e saj. Ligji Nr 7703 “Për sigurimet shoqërore” parashikon se për të përfutur pension te pjesshëm pleqërie shtetëror

personi duhet të ketë mbushur moshën për pension dhe të ketë bërë jo me pak se 20 vite pune nga të cilat 17 vite pune të jenë në marrëdhënie me shtetin.

Klientia në librezën e saj të punës ka të dokumentuar 28 vite pune nga ku 23 i ka pasur në marrëdhënie me shtetin.

Por nga Drejtoria e Rajonale e Sigurimeve Shoqërore “nuk është marrë në konsiderate një pjesë e periudhës së punës në Ndërmarrjen Artistike nga 16.03.1970 – 16.03.1977, pasi siç rezulton nga vërtetimi i arkivës





në dt. 27.03.2008, viti i fillimit është i korigjuar dhe për rrjedhojë nuk i është njohur e drejta për pension të pjesshëm pleqërie shtetëror.

Argumenti i përdorur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, është i pambështetur në ligj, pasi klientia dispononte librezën e punës origjinale e cila përfaqëson një dokument zyrtar dhe si e tillë ajo mund të kundërshtohet vetëm “për falsitet” (neni 253 i Kodit të Procedurës Civile).

Në këto kushte avokati i TLAS,

filloi punën për t’i ardhur në ndihmë klientes. Si fillim u hartua kërkesa ankimore pasi duhet që të ezaurohet rruga administrative e ankimit, dhe më pas nëse çështja nuk merr zgjidhje administrativisht ajo do të trajtohet në rrugë gjyqësore.

Naureda Llagami
Avokate
TLAS

PROGRAMET E QEVERISË PËR LUFTËN KUNDËR VARFËRISË

Sipas të dhënave të institucioneve ndërkombëtare mbi Shqipërinë përqindja zyrtare e papunësisë është 13.5% dhe 18.5% e popullsisë jeton nën nivelin e varfërisë sipas vlerësimit të varfërisë në 2005. Përafërsisht, 3.5% e Shqiptarëve vazhdojnë të jetojnë në varfëri ekstreme (me më pak se një dollar në

ditë), dhe ekzistojnë pabarazi të dukshme midis zonave rurale dhe atyre urbane.

Shteti shqiptar ka marrë përsipër detyrime kushtetuese të diktuar edhe nga angazhime ndërkombëtare, për të cilat shteti ynë është përgjegjës. Detyrimi kryesor lind nga Kushtetuta, e cila në kreun 4 përfshin të drejtat dhe liritë ekonomike, sociale dhe kulturore, të drejta si, për të punuar, për të gëzuar një jetë familjare, e drejta e arsimimit, e drejta për sigurim shëndetësor etj. Megjithatë në kreun 5, parashikohen objektiva sociale, të cilat Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon duhet t'i realizojë, duke synuar punësimin, strehimin, arsimimin për të gjithë individët dhe përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët etj.

Programi i qeverisë ka si qëllim të krijojë mundësi për:

- Punësim të plotë dhe reduktim të papunësisë nëpërmjet rritjes së pageve dhe pensioneve;



- Reduktimin e varfërisë dhe kufizimit social.

Janë prioritet i Qeverisë dhe Ministrisë së Punës masa të marra:

a. Në fushën e asistencës sociale, Ndihma Ekonomike nga 1 Korriku i këtij viti u indeksua me 10%.


b. Programi i pagesës për personat me aftësi të kufizuara.

c. Për shërbimet sociale, për invalidët e punës, nga 1 korriku 2008, u rrit masa e subvencionimit të karburantit, pagesa për Aftësinë e Kufizuar të Invalidëve të punës u indeksua me 10%; invalidët e punës që vuajnë nga sëmundjet profesionale dhe të aksidentuar në punë, të grupit të parë dhe të dytë, nga 1 korrik 2008 përfitojnë një rritje të pagesës me 35%.

Strehimi

Ligji nr. 9232 date 13.05.2004
“Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave ur-

bane” përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e sigurimit, të shpërndarjes, të administrimit dhe të planifikimit të programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit. Programe sociale strehimi janë programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën





e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Programet sociale të strehimit klasifikohen:

1. Programe të banesave sociale me qira.
2. Programe të banesave me kosto të ulët.
3. Programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë.

Keto u ofrohen familjeve, që kanë të ardhura të pamja-

ftueshme dhe miratohen me vendim të këshillit bashkiak.

Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga: sigurimi i detyrueshëm, vullnetar, suplementar dhe nga pensionet shtetërore të posaçme.

Me kontributet e derdhura garantohet pagesa në para për të kompensuar pakësimin e të ardhurave në një shumë që mbulon të paktën një standard minimal jetese, i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Kur standardi minimal i jetesës nuk arrihet nga pensioni bazë, vendoset një shtesë të ardhurash në formë kompensimi.

Sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme gjithë shtetasit, ekonomikisht aktivë në Shqipëri, në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e barrë lindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes dhe në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë

e paaftësisë së përkohshme të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia.

Personi që bëhet i paaftë, merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë:

a) për çdo veprimtari ekonomike;

b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Invaliditeti caktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP). Invaliditetet është në dy forma, i pjesshëm dhe i përhershëm, në varësi të shkallës së dëmtimit.

Një formë tjetër përfitimi është edhe Pensioni familjar, të cilin përfitojnë personat, si bashkëshortët e ve, jetimi, prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë etj

që janë në ngarkim të personit që vdes, i cili kishte kushte për përfitimin e njërit nga llojet e pensioneve ose merrte pension.

Papunësia

Papunësia llogaritet në bazë të të papunëve të regjistruar në Zyrat e Punësimit.

Kontributet për pagesën e papunësisë mbledhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe transferohen në Fondin Kombëtar të Punësimit, që administron përfitimet.



Pagesa e papunësisë është një ndihmë në të holla që i jepet për një periudhë 12 mujore personave të dalë si të papunë dhe që kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj. Të papunët e regjistruar trajtohen nga dy skema: pagesa e papunësisë dhe ndihma ekonomike. Ata mund të jenë të papunë afatgjatë, të papunë që kanë më shumë se 12 muaj të regjistruar në Zyrat e Punësimit. Për të ulur papunësinë qëllimi mbetet zhvillimi i sistemit të formimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore.

Ky është mjeti kryesor, që ndihmon personat e varfër të përfitojnë mbështetje financiare prej shtetit. Ligji përcakton ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.



Ky ligj zbut varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe krijon mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës. Ndhimë ekonomike është mbështetja, në para e natyrë, e individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë.

Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet në nevojë.
2. Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari.
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.

Ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor, në lekë, ose përfitimi mujor, në natyrë dhe ajo është e plotë ose e pjesshme.

Autoriteti përgjegjës është Këshilli i Bashkisë ose Komunës, njësitë vendore apo komunat menaxhojnë shpërndarjen e Ndhmës ekonomike.

Pagesa për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK)

Nepermjet kesaj skeme trajtohen me pagese (cash) personat e paaftë, të lindur ose të bërë të tillë para moshës 21 vjeç (të paaftë mendore, fizike,) persona me statusin e të verberit, dha persona paraplegjike dhe tetraplegjike.



Projektligji “Për Ndhmën Juridike”

Mungesa e deritanishme e ligjit ka treguar mangësi të mëdha në funksionimin e sistemit.

Në fushën e procedimit penal është konstatuar mungesa e efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit kryesisht për shkak të mungesës së monitorimit, ndërsa në fushën civile dhe administrative ky sistem ka funksionuar vetëm nëpërmjet sistemit të organizatave jofitimprurëse të mbështetura kryesisht nga donatorë të huaj.

Këto mungesa të funksionimit të sistemit kërkojnë domosdoshmërinë e rregullimeve ligjore dhe institucionale të kësaj fushe. Ligji specifik “Për Ndihmën Juridike” synon krijimin një sistemi funksional të ndihmës juridike.

Ligji i propozuar tenton të themelojë një sistem të ndihmës juridike në kushtet konkrete të Shqipërisë. Në kushtet e mungesës së një sistemi funksional, kemi parasysh:

a) nevojën për një organ administrimi me besueshmëri në drejtim të statusit të pavarësisë së shërbimit juridik;

b) nevojën e mbështetjes graduale dhe shtimit të kontributit shtetëror në financimin e këtij sistemi.

Gjithashtu është propozuar ngritja e një strukture të veçantë shtetërore e cila do të funksionojë si një organ përfaqëues i organeve përgjegjëse për funksionimin e këtij shërbimi, “Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike”. Ndër kompetencat me rëndësi të veçantë janë ato që lidhen me zbatimin e politikës shtetërore në dhënien e ndihmës juridike, menaxhimin e buxhetit të akorduar për qëllim të ofrimit të ndihmës juridike nga shteti, miratimin e rregullave të caktimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike, lidhjen e kontratave të shërbimit me avokatët që do të ofrojnë shërbimin.



Anisa Haxhiaj
Avokate/ këshilltare paraligjore
TLAS

Histori e vërtetë

Rasti i klientes SH.T.

Klientja SH.T është transferuar në Tiranë nga një zonë e thellë e Dibrës. Ajo është martuar me D.H me të cilin ka lidhur martesë, që kur ajo banonte në Dibër. Me vendosjen e tyre në një zonë të Tiranës, ata sajuan një banesë me kushte shumë të këqija higjeno-sanitare, ku jetonin bashkë me kafshë. Ndërkohë që çifti jetonte në Tiranë ata nuk kishin realizuar transferimin e të dhënave të gjendjes civile nga Dibra në zonën e re, ku ata banojnë aktualisht. Gjatë jetesës në këtë zonë ata lindën edhe 3 fëmijët e tyre, ndërkohë që në Dibër ata kishin patur dy fëmijë të tjerë.

Klientja u paraqit pranë TLAS pasi ajo kishte të peregjistruar të katër fëmijët e saj. Gjatë intervistës me të u zbulua që familja jetonte në kushte të vështira ekonomike dhe higjieno sanitare dhe që klientja ishte përsëri shtatzanë më fëmijën e pestë.

Dy prej fëmijëve të saj ishin të lindur në Dibër pranë Qendrës Shëndetësore, por klientja kishte humbur çertifikatat e lindjes të institucionit shëndetësor, ku ata ishin lindur. Për shkak të pamundësisë për të tërhequr këto çertifikata TLAS bëri të mundur vajtjen e saj në Dibër duke vënë në dispozicion makinën për ta çuar klienten deri në qendrën shëndetësore të lindjes së fëmijëve të saj. Në të njëjtën kohë klientja u ndihmua që të tërhiqte çertifikatat nga gjendja civile për të bërë transferimin e të dhënave të familjes prej regjistrit të gjendjes civile të mëparshme në të renë.





Pas kthimit në Tiranë familja u ndihmua që të realizonte transferimin në zyrat e gjendjes civile të rrethit të Tiranës, në mënyrë që të tërhiqeshin certifikatat për të nisur sa më shpejt procedurat e regjistrimit të fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile.

Duke qenë se familja u interesua për regjistrimin e fëmijëve përpara muajit korrik, procedura e vetme ishte deklarimi i lindjes së fëmijëve nëpërmjet një vendimi të gjykatës. Kështu që TLAS u angazhua në marrjen përsipër të procedurës gjyqësore të kon-

firimit të faktit të lindjes së fëmijëve dhe pas marrjes së vendimit prej gjykatës, shoqërimin e klientes në zyrat e gjendjes civile dhe pagimin e gjobës.

Gjatë zhvillimit të këtyre fazave, klientja lindi fëmijën e pestë, për të cilën ajo u këshillua që ta lindte në institucionin shëndetësor të zonës dhe të kryente deklarin e fëmijës përpara punonjësit të gjendjes civile brenda 60 ditëve, pasi lindja e fëmijës përkonte me ndryshimet e fundit të bëra në ligjin “Për gjendjen civile” dhe sipas të cilit fëmijët e lindur përfitojnë një shumë pre 5.000 lekësh.

Kjo shumë modeste mund ta ndihmonte sadopak klienten të hiqte disa shpenzime minimale për familjen e saj.

Problemi më i madh doli për regjistrimin e dy fëmijëve të tjerë, të cilët kishin lindur në Tiranë, por jashtë kushteve të institucioneve shëndetësore. Klientja ishte ndihmuar nga të afërmit e saj për lindjen e fëmijëve në banesën

me kushte të këqija, ku familja jetonte.

Gjykata është i vetmi organ, që mund të realizojë vërtetimin e faktit të lindjes së fëmijëve, dhe për këtë arsye TLAS iu drejtua asaj me një kërkesë. Megjithatë realizimi i këtyre proceseve gjyqësore nuk ishte aspak i lehtë. Avokatja ka vizituar shtëpinë e klientes duke kontaktuar disa herë me familjarët dhe komshinjtë e klientes, për të marrë informacion për lindjet dhe për t'i shpjeguar atyre sesi ata mund të ndihmonin dhe të dëshmonin në gjyq.

Më pas u kontaktua kryeplaku i fshatit dhe punonjësja e gjendjes civile, të cilët lëshuan vërtetime, që ata ishin në dijeni të familjes, ku banonte ajo dhe të fëmijëve të paregjistruar të klientes. Gjithashtu ata u bindën dhe pranuan të dëshmonin në gjykatë.

Pas gjithë këtyre kontaktimeve mbetej që fëmijët të vizitoheshin prej mjekut të zonës, i cili duhej të lëshonte një vërtetim për gjend-

jen e tyre shëndetësore dhe për faktin se ata, që prej lindjes ishin vizituar dhe vaksinuar në këtë qendër shëndetësore. Mjeku dhe infermierja e qendrës pasi kryen kontrole mjekësore dhe kontrollojnë regjistrat e vizitave mjekësore lëshuan vërtetimin, ku ata theksonin se fëmijët ishin trajtuar në qendrën shëndetësore që në ditët e para të jetës së tyre. Madje dy infermiere të qendrës pranuan që edhe ato të ishin si dëshmitare në procesin gjyqësor.



Proçesi gjyqësor zgjati disa muaj pasi sigurimi i vërtetimeve dhe dëshmitarëve kërkoi kohë dhe u realizua pas kontakteve të shumta.

Pas disa muajsh seancash gjyqësore, gjykata pranoi kërkesën dhe konfirmoi faktin e lindjes së dy fëmijëve të klientes Sh.T. Në fund të 5 fëmijët e saj figurojnë të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.

Klientja filloi më pas procedurën për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, në mënyrë

që të gjente një përkrahje financiare për të lehtësuar gjendjen e saj tepër të vështirë ekonomike.

Anisa Haxhiaj
Avokate/këshilltare paraligjore
TLAS



Histori e vërtetë

Rasti i klientes M.Z.

TLAS është përpjekur që ndihmën dhe kontributin e tij në ndihmë të personave në nevojë ta shtrijë edhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jo vetëm në kryeqytet, pasi njerëzit në nevojë hasen me vështirësi kudo në Shqipëri.

Gjatë realizimit të aktiviteteve street law në komunën Mbro-

star, në qytetin e Fierit së bashku me studentët, kontaktua me shumë anëtarë të komunitetit rom, që banon në këtë zonë. Ata kishin mjaft probleme ligjore përveç atyre ekonomike, si regjistrime të fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile, transferime, zgjidhje martese etj.

Duke marrë dijeni për vajtjen e stafit të TLAS në këtë komunë, pranë nesh u paraqit A.P, i cili fillimisht u interesua për regjistrimin e lindjes së mbesës së tij. Djali



i A.P është i moshës 19 vjeç dhe është i martuar, pa lidhur martesën ligjore me M.Z, e cila është 16 vjeçe dhe me të cilën ka një fëmijë vajzë, disa muajshe. Prindërit duke qenë në moshë të mitur në momentin e lindjes së fëmijës, nuk kishin bërë deklarin e lindjes së fëmijës në regjistrat e gjendjes civile pasi mendonin se mosha e tyre do t'i pengonte në këtë procedurë. Avokatja e TLAS u shpjegoi se deklarimi i fëmijës bëhet pavarësisht moshës së prindërve dhe punonjësi i gjendjes civile

ka detyrimin të regjistrojë fëmijën. Problemi që u evidentua ishte se klientja M.Z kishte lindur fëmijën në qytetin e Tiranës dhe nuk kishte mjete dhe mundësi të mjaftueshme të udhëtonte në Tiranë e të tërhiqte çertifikatën e maternitetit të fëmijës. TLAS mundësoi transportin e saj në qytetin e Tiranës në maternitet, me mjetet e tij.

Klientja M.Z dhe bashkëshorti i saj u këshilluan që të bënin deklarin e fëmijës në një nga zyrat e gjendjes civile të prindërve të fëmijës, duke u shoqëruar me dokumenta identifikues me fotografi. Prindërit e fëmijës u shoqëruan në zyrën e gjendjes civile të bashkëshortit të M.Z, pasi ata ranë dakord për këtë më parë. Regjistrimi i fëmijës u krye, por prindërit kërkuan të lidhnin martesën ligjore ndonëse nëna nuk kishte mbushur moshën ligjore për të lidhur martesë sipas Kodit të Familjes.

Po sipas nenit 7 të këtij kodi, prindërve nën moshë u jepet një mundësi të lidhin martesën



ligjore përpara arritjes së moshë 18 vjeç, kjo realizohet duke iu drejtuar gjykatës dhe në rastin e ekzistencës së një shkakut me rëndësi. Gjykata në përgjithësi ka konsideruar në praktikën e saj si “shkak me rëndësi” shtatzaninë apo lindjen e fëmijës. Lindja e fëmijës është një shkak i rëndësishëm, i cili u pranua prej gjykatës për të lejuar lidhjen e martesës mes prindërve pavarësisht faktit se prindërit nuk kanë arritur moshën madhore.

Gjithashtu gjatë gjykimit u paraqitën si dëshmitarë edhe të afërmit e klientes dhe bashkëshortit të saj, të cilët dëshmuuan për faktin se ata bashkëjetojnë prej kohësh.

Pas dhënies së vendimit të gjykatës për lejimin e martesës ligjore u realizua martesa mes tyre në regjistrat e gjendjes civile.

Anisa Haxhiaj
Avokate/këshilltare paraligjore
TLAS

EMRI, MBIEMRI SI PËRBËRËS TË GJENDJES CIVILE KUR DHE SI MUND TE NDRYSHOHEN

Një nga konceptet më të rëndësishme që është parashikuar në Ligjin “Për Gjendjen Civile” është edhe kapitulli që ka lidhje me emrin, mbiemrin dhe shkaqet kur ai mund të ndryshohet si dhe procedurat përkatëse.



Në momentin që lind një fëmijë prindërit e tij duhet të paraqiten tek punonjësi i Gjendjes Civile për të bërë regjistrimin e fëmijës; ky fëmijë i cili do regjistrohet duhet patjetër të ketë një emër. Emri bën pjesë tek ato rubrika të cilat janë të detyrueshme dhe të domosdoshme. Neni 36 i ligjit “Për Gjendjen Civile” parashikon se nëpunësi i gjendjes civile, në aktin e lindjes pasqyron emrin që dëshirojnë prindërit e fëmijës, përveç emrave të papërshtatshëm me karakter fyes, imoral ose racist. Pra ligjvënësi ka krijuar,

në një farë mënyre, një mbrojtje me qëllim që të mos ketë emra që mund të kenë kuptime të tjera ose të jenë emra që nuk përshtaten në gjuhën shqipe, madje në çdo zyrë të gjendjes civile të Shqipërisë ekziston një listë me emra të cilët nuk mund t’u vihen fëmijëve që lindin.

Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore.

Kur prindërit nuk bien dakord për emrin e fëmijës, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër me shënimin në kllapa “i përkohshëm” deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata.

Nuk ka papërshtatshmëri sipas këtij ligji, kur shkakua ka lindur pas regjistrimit të emrit. Pra nëse regjistrimi i fëmijës është bërë nga prindërit dhe më pas kanë lindur shkaqe që mund të kenë ndikuar tek prindërit ata nuk mund t’i drejtohen gjykatës për t’u ankuar sipas parashikimeve të mësipërme.

Drejtori i përgjithshëm i Gjendjes Civile, kur konstaton një emër të papërshtatshëm, ka të drejtë të



kërkojë ndryshimin e tij me vendim gjyqësor.

Kur prindërit kanë vdekur, nuk janë në gjendje fizike ose mendore, apo nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë e, në mungesë të tyre, si për foshnjën e gjetur që nuk i dihen prindërit.

Mbiemri është ai i prindërve. Kur secili nga prindërit ka mbiemër të veçantë, vendoset mbiemri i babait dhe, kur e kërkon nëna, të dy mbiemrat. Kur nuk ka atësi të njohur, fëmijës i vendoset mbiemri i nënës. Fëmija jashtë martese merr mbiemrin e vajzërisë së nënës. Pra ligji ka parashikuar të gjitha rastet e mundshme se cili do të jetë mbiemri që do të ketë fëmija.

Gjithashtu ligji ka parashikuar edhe rastet kur emri ose mbiemri mund të ndryshohen si dhe procedurën që duhet ndjekur. Neni 37 i ligjit “Për Gjendjen Civile” parashikon se emri e mbiemri mund të ndryshojnë në rastet e përcaktuara në këtë ligj ose

për shkaqe të arsyeshme. Nuk mund të ndryshojnë emri e mbiemri i një personi ndaj të cilit ka kallëzim ose ka nisur procedimi penal, deri në përfundimin e tij.

Emri e mbiemri i madhorit mund të ndryshojnë vetëm me kërkesën e tij ose të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj, për rastet e papërshtatshmërisë. Emri i personit mund të ndryshojë pas vdekjes, me kërkesë të personave që kanë atë emër përbërës të gjendjes së tyre civile, dhe që përfshihen në të



njëjtën fletë familjare të regjistrit themeltar të zyrës së gjendjes civile të vendbanimit, vetëm për shkak të papërshtatshmërisë.

Shërbimi i gjendjes civile përcakton emrat e papërshtatshëm në kuptimin e këtij ligji, duke marrë mendim paraprak nga institucione të specializuara. Emrat e vlerësuar të papërshtatshëm me vendim gjyqësor përfshihen drejtpërdrejt në përmbledhësen, që i vihet në dispozicion çdo zyre të gjendjes civile. Ndryshimi i emrit e i mbi-

emrit të prindit pasqyrohet te fëmija i mitur. Te fëmija madhor ndryshimi mund të bëhet me pëlqimin e tij, përveç rasteve të papërshtatshmërisë.

Ndryshimi i emrit e i mbiemrit bëhen në librin e procesverba-
leve, pas miratimit të kërkesës së shtetasit nga punonjësi i zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar. Në procesverbal pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri të ndryshuar. Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga punonjësi i gjendjes civile dhe drejtuesi i zyrës së gjendjes civile, nëse ka të tillë. Emri e mbiemri të ndryshuar, si dhe numri dhe data e procesverbalit pasqyrohen në regjistrin themeltar të gjendjes civile.”

Mbi bazën e procesverbalit ose vendimit gjyqësor, bëhen korigjimet në fletën familjare



për personat që kanë nënshkruar dhe për të miturit, ndërsa për pjesëtarët e tjerë madhorë vetëm pasi të kenë dhënë pëlqimin me shkrim, të nënshkruar, të procesverbalit, përveç rasteve të vendosura nga gjykata. Personat që e kanë përbërës emrin ose mbiemrin, por që janë familje më vete, bëjnë ndryshimin, me kërkesën e tyre ose kryesisht nga zyra e gjëndjes civile, me procesverbal të veçantë në regjistrin përkatës, ndërsa në rastet e papërshtatshmërisë, janë të detyruar të pasqyrojnë ndryshimin brenda 1 muaji nga marrja dëgjimi.

Përveç korigjimeve të mësipërme, emrit dhe mbiemrit mund t'i bëhen përmirësime dhe korigjime, që lidhen me ndryshime e saktësime të shkronjave të veçanta, si rezultat i gabimeve materiale të bëra gjatë hartimit apo transferimit të të dhënave. Këto ndryshime bëhen mbi bazën e kërkesës së personit të interesuar, bazuar në një nga dokumentet që vërtetojnë identitetin e të njëjtit person.



Ndryshimet dhe korigjimet e bëra në zyrën ku ndodhet regjistri themeltar i gjëndjes civile u dërgohen, brenda 10 ditëve, Zyrës së Gjendjes Gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe qendrave të rekrutim-mobilizimit të qarqeve përkatëse.

Adrian Shega
Avokat, Këshilltar Paraligjor
TLAS

Histori e vërtetë

Pranë Zyrës sonë rreth 1 vit më parë u paraqit një kliente e komunitetit Rom të qytetit të Elbasanit me iniciale V.I. Pasi ishte vënë në dijeni për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë dhe nëpërmjet fletëpalosjeve të shpërndara pranë qendrave ku banon kjo pjesë e popullsisë, ajo u paraqit duke kërkuar regjistrimin e lindjes së tre fëmijëve të saj.



Pas një interviste me klienten V.I u identifikuan problemet e saj. Nga intervista u konstatua se klientja V.I kishte lindur tre fëmijë jashtë martese me shtetasin Gj.K dhe pavarësisht se lindjet kishin ndodhur në institucionet e njohura nga ligji ato nuk ishin deklaruar përpara nëpunësit të gjendjes civile. Gjithashtu, nga intervista me klienten V.I u konstatua se një ndër shkaqet që kishin penguar regjistrimin e fëmijëve të saj ishte pikërisht fakti se klientja V.I e kishte vendbanimin në qytetin e Beratit. Shkak tjetër ishte edhe mosnjohja e ligjit. Personi me të cilin ajo bashkëjetonte nuk ndodhej në Shqipëri dhe ajo nuk mund të shkonte në Berat për shkak hasmërie.

Çështja u paraqit në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se përveç faktit të regjistrimit të fëmijëve të saj klientja V.I kishte shprehur dëshirën që të transferonte gjëndjen e saj familjare nga qyteti i Beratit në qytetin e Elbasanit, gjithashtu kërkonte që të lidhte martesë ligjore me shtetasin Gj.K.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që fillimisht të transferonim gjendjen familjare të klientes V.I në Elbasan dhe më pas të procedonim me regjistrimin e fëmijëve pranë zyrës së gjëndjes civile të Elbasanit. Përsa i përket faktit që kërkuësja kishte shprehur dëshirën për të lidhur martesë me shtetasin G.J.K, kjo gjë ishte e pamundur të bëhej për sa kohë shtetasi G.J.K qëndronte jashtë Shqipërisë, pasi ligji i kërkon të dy bashkëshortët e ardhshëm që të paraqiten përpara nëpunësit të gjëndjes civile dhe të firmosin personalisht aktin e martesës. Kështu u mendua që të procedohej me dy hapat e tjerë.

Duke qenë se klientja V.I kishte probleme hasmërie në Berat u mendua që të përpilohej një prokurë ku ajo të autorizonte një nga avokatët e zyrës që të realizonte të gjitha procedurat e nevojshme për transferimin e gjëndjes civile të saj në qytetin e Elbasanit. Pasi u përpilua prokura, dy nga avokatët e zyrës shkuan në qytetin e Beratit por nga zyra e gjëndjes civile të

Beratit u këndërshtua transferimi duke e refuzuar në këtë mënyrë kërkesën e klientes V.I, me arsyetimin se për të kryer veprimet e transferimit duhet të paraqitet vetë personi.

Pas diskutimeve të shumta u mendua që të shkohej një ditë bashkë me klienten V.I në qytetin e Beratit duke marrë parasysh faktin që klientja e kishte të vështirë të paraqitej për shkaqet e përmendura më sipër, për të kryer procedurat e nevojshme për transferim.



Pasi shkua në qytetin e Beratit dhe u paraqitëm në Zyrat e Gjendjes Civile, klientja V.I ishte në një trung familjar me pesë persona të tjerë. U mendua që të kryente proceduarat e veçimit familjar pasi ligji ja njehtetë të drejtë çdo personi që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç. Pasi u realizua veçimi u morën certifikatat e nevojshme për të realizuar transferimin e gjendjes familjare të klientes V.I.

Të gjitha këto dokumente u paraqitën në zyrën e gjendjes civile të Elbasanit që i takonte

vendbanimit të kërkueses duke u shoqëruar edhe me një kërkesë nga ana e saj për të bërë të mundur transferimin.

Pasi u plotësuan afatet ligjore u arrit të bëhej i mundur transferimi i gjendjes civile të kërkueses në qytetin e Elbasanit.

Më pas u procedua me regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile, pasi i mblodhëm të gjitha certifikatat e lindjes së fëmijëve bashkë me kërkuesen u paraqitëm në zyrat e gjendjes civile dhe me dokumentat e maternitetit arritëm të bëjmë të mundur regjistrimin e fëmijëve në fletën familjare të nënës së tyre.

Kështu këta fëmijë mund të gëzojnë dhe të përfitojnë të gjitha të drejtat që ligji ua njehtetë atyre. Vlen të theksohet se problemet që kemi hasur gjatë punës me popullsinë Rome janë mjaft të ndërlikuara, por pavarësisht këtyre pengesave Qendra për Shërbimin Ligjor Falas Tiranë ka bërë të gjitha përpjekjet e



nevojshme që ti vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit Rom të Tiranës por edhe atij komuniteti që banon në qytete të tjera të Shqipërisë.

Adrian Shega
Avokat, Këshilltar Paraligjor
TLAS



BENCHMARK INSTITUTE, NJË EKSPERIENCË E PAHARRUESHME

Instituti Benchmark në San Francisco, Kaliforni, është një institut me karakter edukues, i cili zhvillon trajnime për avokate, juristë/këshilltarë paraligjorë si dhe për subjekte të tjera që ofrojnë shërbime që kërkojnë njohuri ligjore. Themeluar që më 1989, Benchmark ofron trajnime të





vazhdueshme nëpërmjet programeve të tij të ndryshme, si për zhvillimin e aftësive si jurist, ashtu edhe rritjen e njohurive ligjore në fushën e së drejtës familjare, strehimit dhe ndihmës shoqërore. Deri më sot Benchmark ka trajnuar mbi 8,500 persona dhe qindra zyra që japin shërbim ligjor falas apo organizata jofitimprurëse në SHBA dhe më gjerë. College of Advocacy është një nga trajnimet e realizuar prej Benchmark Institute prej mëse 20 vjetësh. Ky është një lloj trajnimi i tipit “ tre në një”, duke qene

se fokusohet në tre drejtime: ngritjen e aftësive si jurist, ngritjen e njohurive ligjore për çështjet e ndryshme që i interesojnë personave me të ardhura të pakta, si dhe në ngritjen e aftësive të lidërshiptit. Benchmark në eksperiencën e tij të gjatë ka arritur të identifikojë aftësitë dhe njohuritë ligjore që i nevojiten avokatëve, këshilltarëve, dhe asistentëve ligjorë në praktikën e përditshme të punës së tyre me klientë me të ardhura të pakta. Trajnimi ka një karakter mjaft interaktiv dhe ofron mundësi të panumërta për

të praktikuar aftësi të ndryshme si intervista, negocimi , zgjidhja e mosmarrëveshjeve etj.

TLAS është i përkushtuar të rrisë jo vetëm sasinë, por edhe cilësinë e shërbimit ligjor falas përkundrejt personave që e përfitojnë atë, dhe kuptohet që trajnimi i stafit është i nevojshëm për të arritur këtë objektivë. Po kështu fushat në të cilat do të fokusohet trajnimi i College of Advocacy 2008 , kishin të bënin me ofrimin e shërbimit ligjor falas në fushën familjare, stehimin dhe ndihmën shoqërore, që janë pikërisht fushat në të cilat operon edhe TLAS. Pra, objekti i këtij trajnimi dhe fushat që ai mbulon përqaseshin jo vetëm me kërkesat individuale si një juriste e sapodiplomuar, por edhe me objektivat dhe fushën e veprimtarisë së TLAS.

Në College of Advocacy 2008, te mbajtur më 10-17 Tetor, ishin pjesëmarrës 37 persona, të punësuar në zyra të ndryshme që ofrojnë Shërbim Ligjor Falas në shtete të ndryshme të SHBA, në funksionin e avokatit apo këshilltarit paraligjor. Pjesa e parë e

trajnimin ishte e fokusuar në zhvillimin e aftësive si jurist: si të marrim në pyetje klientët- ku kuptohet bëhet fjalë për klientë që kanë të ardhura të pakta, e shpesh edhe të paarsimuar- si të analizojmë faktet dhe si të identifikojmë problemet kryesore të një çështjeje, si të mbledhim provat etj. Risi për mua ishte rëndësia që i jepej negocimit në zgjidhjen e një çështjeje. Në fakt ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nuk është një praktikë e përhapur gjerësisht në vendin tonë. Në rast konfliktesh personat preferojnë t'u drejtohen gjykatave, sesa të zgjidhin çështjen me pajtim, ndoshta sepse nuk janë të ndërgjegjësuar për beneficitet e këtij mekanizmi (negocimit), ose pjesërisht pasi kostoja e fillimit të një procedure gjyqësore nuk është ende aq e lartë sa në vendet fqinje (kujtojmë që kostoja e depozitimit të një kërkesë të thjeshtë në Gjykatë është vetëm 100 lekë).

Po kështu personalisht e vlerësoj me shumë interes njohuritë e marra për mënyrën e zhvillimit

të procesit gjyqësor si dhe në të drejtën materiale në fushën civile, ku pavarësisht ndryshimeve që ekzistojnë me sistemin tonë të së drejtës, parime të përgjithshme të së drejtës gjenin zbatim edhe këtu. Mund të përmend kështu psh. Ezaurimin e ankimit administrativ para se të kalohet në ankimin gjyqësor, mosdiskriminimi, apo të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parimi “ne bis in idem” (mosgjykimi dy here i së njëjtës çështje) etj.

Përsa i përket të drejtës materiale në fushën familjare, strehimit dhe ndihmës shoqërore, është afërmendsh që niveli i ofrimit të ndihmës ligjore falas në këto fusha ishte shumë i avancuar. Këtu vetë shteti amerikan kishte krijuar një sërë programesh por edhe ligjesh që garantonin një shumëllojshmëri shërbimesh për kategori të ndryshme personash në nevojë. Mjafton të përmendim sektorin e përkujdesjes shëndetësore ku ekzistonin disa programe si: Medicaid, Medicare, Programi i Sigurimit për Fëmijët, programe lokale dhe

shtetërore për personat e varfër, Shërbim Shëndetësore për Pensionistët Veteranë etj. Ekzistenca e shumë programeve në ofrimin e shërbimit, si për mbrojtjen dhe përkujdesjen shoqërore ashtu edhe më gjërë, e bën efektiv realizimin e këtij shërbimi, pasi kështu ai është i specializuar për kategori të ndryshme personash, duke iu përgjigjur nevojave të tyre reale. Vendi ynë është ende larg në rritjen e krijimit të një pakete të plotë për mbrojtjen shoqërore, dhe ka vend për ndryshime në legjislacionin përkatës në këtë fushë, duke iu përafëruar standarteve europiane e më gjërë, drejt të cilave aspirojmë.

Po kështu përpjekja për rritjen e cilësisë së shërbimit ligjor falas nëpërmjet hartimit të projektligjit “Ndihma Ligjore Falas në Republikën e Shqipërisë”, shënon një hap të rëndësishëm në këtë drejtim. Këtu vlen të përmendet puna këmbëngulëse që ka bërë TLASjo vetëm në ndërgjegjësimin e aktorëve për nevojën e një ligji të tillë, por edhe në hartimin e projektligjit duke dhënë kontributin e ekspertëve të saj. Në

fakt, TLAS beson se ekzistenca e një kuadri ligjor dhe të një institucioni përgjegjës do të jenë filtra për shmangien e abuzimeve në këtë sektor, sikundër edhe garantë të cilësisë.

Metodologjia e trajnimit është një meritë tjetër e organizatorëve. Kombinimi i brain-storming (të menduarit të shpejtë), me punën në grup, apo prezantimi i punimeve dhe simulimi i seancave gjyqësore, i shërbyen shumë mirë parimit “Te nxësh duke vepruar”. Duke siguruar

një atmosfere jo-formale (shume ndryshe nga auditoret e shkollave), secili kishte mundësinë të eksperimentonte atë çfarë kishte mësuar, duke vënë në punë njohuritë e përfituara dhe duke patur mundësi të njihje pikat e veta të dobta dhe të forta.

Aftësimi në punën në grup, në komunikimin me klientët, kolegët apo eprorët, respektimi i vlerave, vlerësimi i diversitetit të ideve dhe kulturave të ndryshme, ishin elementë që u thek-



suan gjatë gjithë trajnimit, si të domosdoshme për ta bërë të suksesshme punën në organizatat jofitimprurëse, apo në struktura të tjera që japin shërbim ligjor falas. Kuptohet se kultivimi i këtyre cilësive është një proces i vazhdueshëm, por identifikimi i tyre si elemente bazë të vepërimtarisë së përditëshme do të thotë të hedhësh themelet e një bashkëpunimi të mirë në nivel horizontal (me anëtarët e stafit), sikundër në nivel vertikal (me eprorët), ç'ka në nivel të fundit

rrit cilësinë e punës dhe çon në përmbushjen e suksesshme të objektivave të organizatës. Benchmark Institut është i përkushtuar në ndërtimin e një komuniteti ligjor që kujdeset për vlerat, dhe që trajton me kompetencë çështjet që merr përsipër. College of Advocacy është padyshim një nga trajnimet që i përmbush mjaft mirë këto objektiva dhe qenia pjesë e tij është patjetër një privilegj dhe një eksperiencë që të rrit jo vetëm në nivelin profesional “af-tësi dhe njohuri ligjore” por edhe në atë personal.



Fjoralba Caka
Ass. Avokate
TLAS



AKTIVITETET *STREET LAW* TË TLAS, NË PERIU DHËN SHTATOR-NËNTOR.

Një ndër mënyrat shumë të rëndësishme të ofrimit ligjor nga zyra “Shërbimi Ligjor Falas Tiranë” janë pikërisht aktivitetet e formës *Street Law* (ndërgjegjësimit ligjor të publikut) që organizohen për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit publik për të drejtat e njeriut dhe çështjet ligjore e sociale. Ky është një aktivitet që udhëhiqet nga studentët e Programit Internship të TLAS, që kryejnë praktikën mësimore pranë kësaj zyre. Në kuadër të këtij aktiviteti studentët udhëtojnë çdo javë nëpër zonat urbane dhe rurale të ndryshme.

Grupi i studentëve transmeton informacionin e nevojshëm për shërbimet e zyrës, shpërndan publikimet e përgatitura nga stafi i zyrës për të rritur aksesin e komunitetit për drejtësi. Ajo çka është më e rëndësishme konsiston pikërisht në njohjen e këtyre

komuniteteve apo lokaliteteve me shërbimet që TLAS mundëson. Me qëllim që t'i gjendemi sa më pranë banorëve të këtyre zonave, ku është vënë re një mungesë e theksuar informacioni, ne mundohemi që të kontaktojmë me sa më shumë prej tyre.

Një moment i rëndësishëm është takimi me çdo individ, banor të zonës së vizituar nga studentët e TLAS. Nëpërmjet këtij takimi, studentët u shpjegojnë dhe i informojnë banorët rreth shërbimit





ligjor falas dhe mundësive të shumta që ai ofron për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Gjatë këtyre takimeve, pjesëtarëve të komunitetit iu shpërndahen botimet e radhës të TLAS të pasura me informacione të dobishme për atë që më vonë mund të kthehet në klient të zyrës sonë. Në këto revista e botime janë të publikuara edhe mënyrat e kontaktit me zyrën të cilat iu komunikohen edhe verbalisht çdo individ që studentet takojnë. Studentët njihen më nga afër me komunitetin, flasin nga afër me to dhe njihen më mirë me problemet e shumta që kanë këta njerëz.

Ne i takojmë personalisht ata, shkojmë në çdo shtëpi, shkojmë në vendet ku ato punojnë në mënyrë që të njihemi nga afër dhe t'i prekim realisht problemet e tyre.

Gjatë vitit 2008, në periudhën Shtator-Nentor, janë zhvilluar aktivitetet të tipit *Street Law* në shumë zona e kryesisht në tre rrethe të Shqipërisë, Tiranë, Elbasan, Fier. Të gjithë këto aktivitete të *Street Law* janë zhvilluar me komunitetet me duke menduar se ky komunitet ka me të vërtetë nevojë të shumta të natyrës ligjore të cilat i ofron zyra jonë. Gjatë kësaj periudhe ne kemi realizuar 6 (gjashtë) aktivitete *Street Law*. Tre në Tiranë, dy në Fier dhe një në Elbasan.

Më datë 25 shtator aktiviteti *Street Law* u zhvillua në lagjen 5-Maji në qytetin e Elbasanit. Në këtë zonë shihej si problem numri i madh i fëmijëve të paregjistruar. Komuniteti i kësaj zone u informua për ligjin e ri për regjistrimin e lindjeve. Kjo u realizua verbalisht nga ne, por edhe nëpërmjet posterave që vendosëm nëpër

vende të dukshme për të informuar edhe persona të tjerë që nuk ishin të pranishëm gjatë shpjegimeve tona.

Gjithashtu ndeshëm raste nga individë të ndryshëm për problemin e asistencës ekonomike dhe disa raste për zgjidhje martesë.

Street Law i radhës u zhvillua në Minibashkinë Nr.11 në qytetin e Tiranës. Vizituam fillimisht disa banesa në Kodër-Kamëz ku folëm me banorët për problemet më të përgjithshme që ndeshnin ata lidhur me çështjet ligjore. Vihej re edhe në këtë zonë problemi i fëmijëve të paregjistruar. Ato u informuan për ligjin e ri për gjendjen civile rreth regjistrimit të lindjeve. Gjithashtu ndeshëm raste nga individë të ndryshëm për problemin e përfitimit të ndihmës ekonomike, disa raste për zgjidhje martesë, rreth çështjes së pensionit, largimin e padrejtë nga puna etj.

Me datë 9 tetor *Street Law* u zhvillua në komunën e Drizës

në qytetin e Fierit. Në këtë zonë ishte përqëndruar një pjesë e mirë e komunitetit rom të qytetit të Fierit ku kishte mbi 350 familje të komunitetit rom. Banorët e këtij komuniteti kishin probleme të shumta të natyrës ligjore. Atje ne takuam shumë banorë të cilët na folën për problemet e tyre. Stafi jonë vendosi të bënte edhe disa *Street Law* të tjera duke parë se kjo zonë kishte më të vërtet nevojë për shërbime ligjore falas.



Me datë 13 tetor aktiviteti Street Law u zhvillua ne Selitë, Tiranë. Patëm takim me banorët të cilët na paraqituan problemet e tyre ku problemi më i pranishëm në këtë komunitet ashtu si dhe ne Street Law e mëparshëm vazhdonte të ishte mosregjistrimi i lindjeve.

Në muajin tetor, aktiviteti i radhës u zhvillua në Mbrostar dhe Drizë të qytetit të Fierit. Puna jonë u përqëndrua në informimin e banorëve për shërbimet falas që realizon zyra jonë.

Aktiviteti i fundit *Street Law* u

realizua në Paskuqan. Atje ne takuam shumë banorë të këtij komuniteti të cilët kishin si problem shumë shqetësues regjistrimin e lindjeve dhe përfshirjen në skemën e ndihmës ekonomike. Ne vumë re se edhe pse jetojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë këta njerëz ndajnë me njëri-tjetrin të njëjtat probleme ligjore dhe sociale. Probleme ligjore të regjistrimit të lindjeve, zgjidhjes së martesave, ndihmës ekonomike etj.

Çka të bie menjëherë ndër sy në këto zona, është pikërisht mjerimi në të cilin ata jetojnë, kushtet e vështira dhe diskriminimi të cilin e hasin çdo ditë. Duke regjistruar numrin më të madh të problematikave tashmë ata janë kthyer në vëmendjen e zyrës sonë.

Gjithashtu gjatë periudhës shtator-nëntor të vitit 2008, fushata kryesore e TLAS u përqëndrua në regjistrimin e lindjeve si dhe në zgjidhjen e problemeve të tjera të karakterit civil. Gjatë këtyre aktiviteteve është vënë re mungesë e totale informacioni lidhur me legjislacionin në fuqi.



Në shumë raste disa prej banorëve na kanë dorëzuar në vend dokumentat që na duhen për ndjekjen e hapave të mëtejshëm ligjor deri në përfundimin e procesit ligjor. Kjo fushatë është zbatuar me përpikmëri dhe me sukses nga studentët e Programit të Internship të TLAS nëpërmjet aktiviteteve *Street Law*.

Anila Alliu
Nertila Bulku
Studente te Programit Internship
TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Nr. 3 / 2008

TLAS

